



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 25 shtator 2023  
Nr. ref.: RK 2267/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI123/23**

Parashtrues

**Mehdi Arifaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së  
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë  
Kosovare të Privatizimit, AC-I-22-0678-A0001, të 9 mars 2023**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mehdi Arifaj, nga Komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [AC-I-22-0678-A0001] e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së) të 9 marsit 2023.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregull) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 7 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën e tij, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi me 9 qershor 2023.
7. Më 15 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka- Nïmani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 27 qershor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
9. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Ndërmarrjen shoqërore "25 Maji", dhe në këtë cilësi iu kishte drejtuar Autoritetit të

Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me kërkesa (i) për kompensimin e 3 (tri) pagave të papaguara në shumën prej 1,095.00 euro; (ii) për kompensimin e 18 (tetëmbëdhjete) pagave të papaguara për periudhën 1 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008 në shumën prej 6, 750.00 euro; si dhe (ii) për kompensim të ndërprerjes së kontratës së punës në shumë prej 2,190.00 euro.

11. Më 20 janar 2014, Autoriteti i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) nxjerri vendimet [PRZO45-0160]; [PRZO45-0161]; [PRZO45-162] përmes së cilave refuzoj kërkesat e lartcekura të parashtruesit të kërkesës si të parashkruara.
12. Më 18 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në DHPGJS kundër vendimeve të lartcekura të Autoriteti të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
13. Më 4 mars 2021, DHPGJS kishte lëshuar një urdher duke kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që ankesën e dorëzuar ta nënshkruaj dhe në të njëjtën kohë e njoftoj se në rast se brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të urdhrin, nuk e dorëzon ankesën e nënshkruar, e njëjta do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.
14. Parashtruesi i kërkesës kishte pranuar urdhrin e lartcekur por nuk iu kishte përgjigjur kërkesave të tij pozitivisht.
15. Më 8 qershor 2021, shkalla e parë e DHPGJS përmes Aktvendimit [C-IV-14-0881] duke u bazuar në nenin 33.1, 36.1 dhe 36.3 të Ligjit nr. 06/l-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për DHPGJS) refuzoj ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme me arsyetimin se ankesa e paraqitur nuk ishte e firmosur.
16. Më 18 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [C-IV-14-0881] të 8 qershorit 2021 në Kolegjin e Apelit të DHPGJS për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike meqë sipas tij nuk kishte pranuar urdhrin e 4 marsit 2021 dhe në fund kërkoi që ankesën ta shqyrtoj dhe ta shpall si të bazuar.
17. Më 25 qershor 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS kishte lëshuar një vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore, përmes së cilës kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se (i) në rast të dështimit të pagesës brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr në kuptim të nenit 234.4 dhe 253.5 të Ligjit [nr.03/L-006] të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) dhe nenit 6.4 e 6.5, si dhe 10.10 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore; si dhe (ii) njoftoj për mundësin e paraqitjes së kërkesës për lirim nga taksat gjyqësore në mungesë të mjeteve financiare.
18. Më 1 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës kishte pranuar vërejtjen por nuk kishte adresuar kërkesat e vërejtjes së 25 qershorit 2021 brenda afatit prej 15 ditësh.
19. Më 29 shtator 2022, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I-21-0407] duke u bazuar në nenin 253.4 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore konsideroj ankesën e parashtruesit të kërkesës si të tërhequr.
20. Më 7 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës pranoi Aktvendimin [AC-I-21-0407].
21. Më 16 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar nenit 130 të LPK-së paraqiti propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme me pretendimin se e kishte

paguar taksen gjyqësore në vlerë prej 30.00 euro dhe në mbështetje të këtij pretendimi kishte dorëzuar si provë fletëpagesën e 4 gushtit 2021.

22. Më 9 mars 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJS përmes Aktvendimit [AC-I-22-0678-A0001] refuzoj propozimin për kthim në gjendje të mëparshme si të paafatshëm me arsyetimin se propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është parashtruar pas afatit të caktuar ligjore, siç ceket në nenin 130 të LPK-së.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin [AC-I-22-0678-A0001] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, të 9 marsit 2023, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës e ndërton rastin mbi pretendimin për shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i (i) refuzimit të kërkesave për kompensim të pagave nga AKP dhe mospranimin të urdhrin të 4 marsit 2021 në mënyrë që të i përgjigjet kërkesave të DHPGJS; (ii) refuzimit të ankesës së tij të 18 qershorit 2021 si të tërhequr nga Kolegji i Apelit të DHPGJS si rezultat i mos pagesës së taksës gjyqësore; (iii) refuzimi i kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme; si dhe (iv) mungesës së shqyrtim të duhur të provave/pretendimeve nga DHPGJS.
25. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se *“parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit për Likuidimin të AKP-së, për kompensim të disa pagave të papaguara për periudhën nga 1 korriku 2007 deri më 31 dhjetor 2008, në shumë prej 6,750 euro. Dhe më 8 qershor 2021, me aktvendimin e shkallës së parë i është hedhur poshtë si e papranuar se ankesa e parashtruar nuk është nënshkruar nga ankuesi. Këtu është bërë një vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, se ankuesi nuk e ka pranuar personalisht urdhrin për nënshkrimin e ankesës nga ana ime”*
26. Parashtruesi tutje pretendon se *“mospranimin i urdhrin personalisht nga ana ime, për ankesën, e cila drejtpërdrejt është e lidhur me interesin tim, e konsideroj se përben shkelje në veti, sepse referuar Ligjit të Dhomës së Posaçme, neni 33, paragrafi 1, ndër të tjera, theksohet. se parashtruesat duhet të jene të shkruara nga pala apo avokati i palës... pra duhet të vlenë edhe për pranimin e shkresave që adresohen nga gjykata tek pala në procedurë e që në këtë rast Urdhri do të duhej të pranohej drejtpërdrejt nga ana ime personalisht.”*
27. Parashtruesi i kërkesës përgjatë pretendimeve të tij thekson se *“Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, e cila ka nxjerrë vendimin AC-1-21-0407, i cili ka njoftuar se ankesa është konsideruar si e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore, edhe pse taksa është paguar, gjë që do të dëshmoj përmes dërgesës së fletëpagesë”*
28. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se *“nuk janë administruar drejt dhe në mënyrë të plotë të gjitha provat shkresore e nuk janë marrë për bazë në mënyrë të duhur asnjëri nga pretendimet e ankesës e sidomos fakti që tani të merret për bazë interesi i tij në procedurë, pasi flitet për kontributin e tij që ka dhënë prej vitesh në N.SH, 25 MAJ në Suharekë, tani i pamundësohet të marrë të ardhurat që i takojnë ashtu siç janë realizuar dhe kanë përfituar të gjithë kolegët apo kontributdhënësit e tij në ndërmarrjen në fjalë, i cili thekson se thekson se shkresat e para të tij, që ta realizon të drejtën që i takon me ligj i janë dorëzuar personalisht nga paditësi, gjë që sipas tij dëshmon që nga fillimi është palë me interes në këtë procedim.”*

29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [AC-I-22-0678-A0001] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, dhe të njëjtin ta kthejë për rigjykim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate; (iv) si dhe të shfuqizoj vendimet [PRZO45-0160]; [PRZO45-0161]; [PRZO45-162] e AKP-së në lidhje me Aktvendimin [AC-I-21-0407] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS të 29 shtatorit 2022.

## **Dispozitat kushtetuese dhe ligjore relevante**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

#### **Neni 6**

#### **(E Drejta për një proces të rregullt)**

*1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

*[...]”*

### **Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore**

#### **Kthimi në gjendjen e mëparshme**

*Neni 130*

130.1 Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.

130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin.

130.3 Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

130.4 Po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë.

### **Përmbajtja e padisë Neni 253**

253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

### **Neni 47 i Ligjit [Kërkesa individuale]**

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*



Neni 48 i Ligjit  
[Saktësimi i kërkesës]

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

Neni 49 i Ligjit  
[Afatet]

*"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesi i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".*

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-22-0678-A0001] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, të 9 marsit 2023, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe i kanë dorëzuar kërkesat në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 34 (2) specifikisht përcakton që:

*Rregulli 34*  
*(Kriteret e pranueshmërisë)*

*"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".*

35. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, dhe [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
36. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS përmes Aktvendimit [AC-I-22-0678-A0001] të 9 marsit 2023, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si rezultat i refuzimit të kërkesës se tij për kthim në gjendje të mëparshme, dhe sipas tij ky refuzim ka afektuar negativisht rezultatit e gjithë procedurës gjyqësore lidhur me kundërshtimin e vendimeve të AKP-së.
37. Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në DHPGJS kundër vendimeve të AKP-së si rezultat i refuzimit të kërkesave të tij për kompensim

page. DHPGJS përmes Aktvendimit [C-IV-14-0881] kishte refuzuar ankesën e parashtruesit meqë kishte dështuar ta firmos ankesën e tij, edhe pas kërkesës se 4 marsit 2021 për nënshkrimin e ankesës. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [C-IV-14-0881] në Kolegjin e Apelit të DHPGJS me arsyetimin se nuk kishte pranuar urdhrin e 4 marsit 2021. Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I-21-0407] duke u bazuar në nenin 253.4 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore konsideroj ankesën e parashtruesit të kërkesës si të tërhequr, meqë nuk kishte paguar taksen gjyqësore edhe pas vërejtjes se 25 qershorit 2021. Më 7 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës pranoi Aktvendimin [AC-I-21-0407] lidhur me arsyet e refuzimit të ankesës se tij, ndërsa më 16 dhjetor 2022, përkatësisht pas 70 ditëve, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar nenit 130 të LPK-së paraqiti propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme me pretendimin se e kishte paguar taksen gjyqësore dhe në mbështetje të këtij pretendimi kishte dorëzuar si provë fletëpagesën e 4 gushtit 2021. Kolegji i Apelit të DHPGJS përmes Aktvendimit [AC-I-22-0678-A0001] refuzoj propozimin për kthim në gjendje të mëparshme si paafatshëm me arsyetimin se propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është parashtruar pas afatit të caktuar ligjore, siç ceket në nenin 130 të LPK-së. Sipas parashtruesit të kërkesës, refuzimi i kërkesës për kthim në gjendjen të mëparshme ka afektuar negativisht rezultatin e gjithë procedurës gjyqësore në rastin e tij lidhur me kundërshtimin e vendimeve të AKP-së dhe rrjedhimisht kjo përben shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e ndërton rastin mbi pretendimin për shkeljen e të drejtës se tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i (i) refuzimit të kërkesave për kompensim të pagave nga AKP dhe mospranimit të urdhrin të 4 marsit 2021 në mënyrë që të i përgjigjet kërkesave të DHPGJS; (ii) refuzimit të ankesës se tij të 18 qershorit 2021 si të tërhequr nga Kolegji i Apelit të DHPGJS si rezultat i mos pagesës së taksës gjyqësore; (iii) refuzimi i kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme; si dhe (iv) mungesës se shqyrtim të duhur të provave/prendimeve nga DHPGJS.
39. Gjykata vëren se lidhur me procedurën gjyqësore iniciues të zhvilluar në DHPGJS, parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon se nuk ka pranuar urdhrin e 4 marsit 2021 të DHPGJS për dorëzimin e ankesës së firmosur nga ana e tij.
40. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se DHPGJS kishte lëshuar një urdher duke kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të firmos ankesën e tij të 18 shkurtit 2014 sipas kërkesave të nenit 33 dhe 35 të Ligjit për DHPGJS ose në rast të dështimit do hedhet poshtë si e papranueshme.
41. Në këtë aspekt, Gjykata duke iu referuar përmbajtjes së Aktvendimit të [AC-I-21-0407] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS të 29 shtatorit 2022 vëren se parashtruesi i kërkesës kishte pranuar urdhrin e lartcekur por kishte dështuar të i adresonte kërkesat e tij dhe rrjedhimisht shkalla e parë e DHPGJS përmes Aktvendimit [C-IV-14-0881] të 8 qershorit 2021 refuzoj ankesën si të papranueshme në kuptim të nenit 33.1 36.1 dhe 36.3 të Ligjit për DHPGJS me arsyetimin se ankesa e paraqitur nuk ishte e firmosur.
42. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se nenin 33 [Paraqitja e parashtrësive] të Ligji për DHPGJS përcakton se *“Origjinali i çdo parashtrëse duhet të nënshkruhet nga pala ose avokati i palës, nëse pala ka përfaqësues të autorizuar. [...]”*
43. Gjithashtu, Gjykata vëren se paragrafi 2.5 i nenit 36 [Pranueshmëria e kërkesës/ankesës] i Ligjit për DHPGJS përcakton se një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse *“kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”*,



44. Gjykata vëren se edhe pas lëshimit të urdhrit të 4 marsit 2021, parashtruesi kishte dështuar që të vepronte sipas kërkesave nga DHPGJS dhe rrjedhimisht kjo ka ndikuar në rezultatin e rasti të tij duke e refuzuar ankesën fillestare si të papranueshme për arsyeje procedurale.
45. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ka paguar taksën gjyqësore dhe në mbështetje të këtij pretendimi kishte paraqitur para Kolegji të Apelit të DHPGJS si provë fletëpagesën e 4 gushtit 2021.
46. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se Kolegji i Apelit i DHPGJS përmes vërejtjes se 25 qershorit 2021, të pranuar nga parashtruesi me 1 korrik 2021 kishte njoftuar këtë të fundit për pagesën e taksës gjyqësore ose paraqitjen e kërkesës për lirim nga taksa brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
47. Në këtë aspekt dhe për më tepër, Gjykata vëren se afati i përcaktuar për pagesën e taksës gjyqësore ishin në pajtim me nenin 5, nën paragrafi 5.5 i Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i cili përcakton se: *“Pala duhet ta paguaje taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë [...]”*
48. Siç rezulton nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka adresuar kërkesat brenda afatit të përcaktuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, dhe rrjedhimisht ankesa e tij ishte konsideruar si e tërhequr nga Kolegji i Apelit i DHPGJS përmes Aktvendimit [AC-I-21-0407] duke u bazuar në nenin 253.4 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.
49. Gjykata do të i referohet edhe pretendimit qendrorë të parashtruesit të kërkesës lidhur me refuzimin e kërkesës për kthim në gjendjen të mëparshme nga Kolegji i Apelit i DHPGJS.
50. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-22-0678-A0001] të 9 marsit 2023 kishte shpjeguar në mënyrë të plotë dhe të arsyeshme pse kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme ishte refuzuar si e papranueshme për shkak se ishte e paafatshme në kuptim të nenit 130 të LPK-së.
51. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS kishte refuzuar kërkesën për kthim në gjendjen të mëparshme me arsyetimin qendrorë se parashtruesi kishte dorëzuar kërkesën e tij pas afatit të caktuar ligjore prej 60 ditëve, siç përcaktohet me nenin 130 të LPK-së.
52. Në këtë aspekt, Gjykata do të i referohet nenit 130 të LPK-së i cili përcakton se
- [...]
- “130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin.*
- 130.3 Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohej kthimi në gjendjen e mëparshme.”*
53. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS arsyetoj se parashtruesi i kërkesës kishte pranuar me 7 tetor 2022 Aktvendimin [AC-I-21-0407] përmes të cilit ishte njoftuar për shkaqet e refuzimit të ankesës se tij si rezultat i mos pagesës së taksës gjyqësore, ndërsa më 16 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës duke iu referuar nenit 130 të LPK-së

paraqiti propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme me pretendimin se e kishte paguar taksen gjyqësore, duke kaluar afatin prej 60 ditëve siç kërkohet me nenin 130 të LPK-së.

54. Në anën tjetër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se ka paguar taksen gjyqësore dhe si rezultat i kësaj ka kërkuar kthim në gjendje të mëparshme, por Gjykata vëren se parashtruesi përsëri kishte humbur afatin për kthim në gjendje të mëparshme para Kolegjit të Apelit të DHPGJS. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është dashur të tregojë *“kujdesin e duhur”* për t'i mbrojtur të drejtat e tij në pajtim me kriteret ligjore.
55. Gjykata konsideron se sqarimi i dhënë i Kolegjit të Apelit i DHPGJS përmes Aktvendimit [AC-I-22-0678-A0001] të 9 marsit 2023, në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit në rastin konkret është i qartë, përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsytimit dhe përfundimeve të nxjerra.
56. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon që të konsiderohet *“[...] interesi i tij në procedurë pasi flitet për kontributin e tij që e ka dhënë me vite të tera ne N.Sh “25 Maji” ne Suhareke tani i pamundësohet te i marre te hyrat qe i takojnë, ashtu siç iu ka takuar dhe kanë përfituar të gjithë koleget e tij apo kontributdhënësi në ndërmarrjen në fjalë”*
57. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se refuzimin i ankesës se tij mund të këtë afektuar në tërësi rezultatit e procedurës gjyqësore lidhur me kërkesat e tij kundër vendimeve të AKP-së. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të trajtoje rrethanat jashtëgjyqësore të parashtruesit të kërkesës. Gjykata vëren se lëshimi i afateve lidhur me kërkesat e tij ka prodhuar efekte juridike në procedurën gjyqësore të zhvilluar në DHPGJS.
58. Gjykata vëren interesin e parashtruesit për realizimin e kërkesës se tij në procedurat e zhvilluar në gjykatat e rregullta, por mungesa e maturisë apo kujdesit të nevojshëm lidhur me respektimin e afateve dhe kryerjen e hapave procedural mund të kontribuoj në mënyrë vendimtare lidhur me rezultatit e rastit të parashtruesit.
59. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar që rezultojë në refuzimin e kërkesës së tij është marrë në mënyrë arbitrare.
60. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatit e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, nr. 5503/02](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
61. Gjykata përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, mutatis mutandis, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#) [DHM], nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ] 1999-1).
62. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, sepse argumentet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ua ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë, siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.

63. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, 31 gusht 2023 njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

**Gjyqtari raportues**

  
Radomir Laban



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka - Nimani